



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 439, datë 04.10.2021

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË SKEMËS SË DELEGIMIT
PËR GJYKIMIN E DISA ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E
POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 377 prot., datë 23.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4351 prot., datë 27.09.2021, Shkresën nr. 378 prot., datë 23.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4352 prot., datë 27.09.2021 dhe Shkresën nr. 379 prot., datë 24.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4353 prot., datë 27.09.2021 mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. Igerta Hysi caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”;
2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259 e 25, 244, 248 të Kodit Penal”;
3. Gjyqtarët ie skemës së delegimit z. Florjan Kalaja dhe znj. Igerta Hysi caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 298/3, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal”.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve Florjan Kalaja dhe Igerta Hysi sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR